



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I BASHKISË SE QYTETIT KORÇE

**VENDIM**

Nr 53 date 5.10.2011

**Per blerjen e truallit prej 97 m2 te ndodhur ne lagjen 12 te qytetit te Korces dhe autorizimin e kryetarit te Bashkise per nënshkrimin e kontrates se shitblerjes**

Keshilli i Bashkise Korce pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe bazuar ne nenin 8 paragrafi II dhe paragrafi VI, nenin 32 te ligjit nr.8562 dt.31.7.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" si dhe ne nenin 705 dhe vijues te Kodit Civil, dhe VKM nr.1620 dt.26.11.2008 "Per miratimin e çmimeve te trojeve qe ndodhen ne disa Bashki dhe ne disa komuna" dhe pas diskutimeve te keshilltareve

**VENDOSI**

1. Te miratoje lidhjen e kontrates se shitblerjes per truallin prej 97 m2 te ndodhur ne rrugen "Raqi Qirinxhi", lgj nr. 12 Korçe me vlere 2 619 000 lek
2. Detyrimi ndaj pronareve te shtrihet ne kater vite, ku per vitin 2011 te shlyhet shuma prej 300 000 lekesh ndersa diferenca te paguhet ne keste te barabarta ne 3 vitet e ardhshme.
3. Per vitin 2011 ky fond do te përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore:

PAKESOHET            00        04980 05        Art.6090000    -300,000 lekë

SHTOHET             00        06260 05        Art.2310000    +300,000 lekë

4. Te autorizojë Kryetarin e Bashkise per lidhjen e kontrates se shitblerjes.
5. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës.
6. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR KESHILLIT**

**Ilirjan PENDAVINJI**